


PRINDERVE TE HUAJ

Si funksionon shkolla fillore në Itali




informacionet e para për mirëpritjen e fëmijëve tuaj



WAA WAA O WAA
WAA WAA O WAA
WAA WAA O WAA
WAA WAA O WAA



WAA WAA WAA
WAA WAA WAA



CIAO!



MIRESEVINI

në vëndin tonë dhe në shkollat tona

Para së gjithash, u themi juve dhe fëmijëve tuaj

“Mirësevini” në Itali dhe në shkollën italiane.

Më poshtë ju japim disa informacione mbi shkollën fillore.

Rregjistroni menjëherë fëmijët tuaj edhe nëqoftëse viti shkollor ka filluar dhe mos harroni që të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë edhe nqs nuk janë në rregull me dokumentacionin e nevojshëm për qëndrim (OKB, Konventa Internacionale mbi të Drejtat e Fëmijës, Neni 28 e DPR 394/99).



1

SA VJET ZGJAT SHKOLLA NE ITALI?

Çerdhja deri në 3 vjeç

Shkolla e fëmijërisë nga 3 deri në 6 vjeç

Shkolla fillore nga 6 deri në 11 vjeç

Shkolla dytësore e shkallës 1° nga 11 deri në 14 vjeç

Shkolla dytësore e shkallës 2° mbi 14 vjeç

Cikli i parë i shkollimit zgjat 8 vjet:

- 5 vjet të shkollës parësore
- 3 vjet të shkollës dytësore të shkallës së parë.

Shkolla fillore është falas. Librat jepen nga shkolla; familjet duhet të blejnë fletoret, stilolapsat, ngjyrat, etj.

Kërkojuni mësuësve listën e materjaleve.

Shënime:

Shkolla e fëmijërisë

- mund të rregjistrohen fëmijët që mbushin tre vjeç brënda datës 30 prill të vitit shkollor të cilit i referohemi (për vitin shkollor 2004-2005: brënda datës 28 shkurt)

Shkolla fillore

- duhet të regjistrohen në klasën e parë fëmijët që mbushin moshën 6 vjeç brënda datës 31 gusht të vitit shkollor të cilit i referohemi

(për vitin shkollor 2004-2005: brënda datës 28 shkurt)

SEGRETERIA

DEPART.	
SECRETARIA	100
PROFESSORI	101
ALUNNI	102
ALTRI	103





ÇFARE DOKUMENTASH NEVOJITEN PER TE RREGJISTRUAR FEMIJET NE SHKOLLEN FILLORE?

Për të rregjistruar fëmijën në shkollë, prindi duhet të plotësojë një formular i cili i jepet në sekretari.

Në të bëhet një autodeklaratë në lidhje me datën e lindjes së nxënësit dhe jepen edhe të gjitha informacionet e kërkuara.

Nëqoftëse ka këto dokumenta:

- certifikatën e lindjes
- certifikatën e vaksinimit
- deklaratën e shkollës që ka frekuentuar në vëndin prej nga vjen


mund ti dorëzojë në Sekretari.

Në rast se mungojnë këto dokumenta, prindi deklaron nën përgjegjësinë e tij, klasën që ka frekuentuar fëmija në vëndin prej nga vjen.


Në momentin e rregjistrimit plotësohen formularët për:

- zgjedhjen e llojit të shkollës (shih numrin 3)
- mësimin e fesë katolike (shih numrin 6)
- rregjistrimin në mensën e shkollës (shih numrin 4)
- rregjistrimin në para-shkollë dhe në lojrat e mbrëmjes

Në rast se nuk keni certifikatën e vaksinimit, drejtojuni asistencës shëndetësor të Sondrios, rruga N.Sauro 33 i cili do tu thotë se c'farë do të bëni



BUON GIORNO!





SHKOLLA ME “KOHE TE PLOTE” APO ME “KOHE NORMALE”?

Në shumë shkolla, prindërit mund të zgjedhin midis dy varianteve të orareve dhe të organizimit shkollor:

- **klasa me “kohë të plotë”**

40 orë në javë nga e hëna në të premte

(27 orë të detyrueshme + 3 ore fakultative + 10 orë mence)

- **klasa me “kohë normale”:**

27 ose 30 orë në javë: 27 orë janë të detyrueshme, 3 fakultative.


Orari javor (1, 2, 3 ose 4 pasdite) përcaktohet nga çdo shkollë.

Menca e shkollës nuk është e detyruar.

Mësimet fillojnë në orën 8.30.

Eshtë e rëndësishme të jeni të përpiktë në orare.

Kërkoni menjëherë orarin e klasës së fëmijës tuaj.



4

SI RREGJISTROHEN FEMIJET NE MENCE?

Në disa shkolla (të gjitha ato që janë në Milano) ekziston shërbimi i mencës shkollore. Prindërit paguajnë për drekën një kuotë e cila ndryshon në bazë të të ardhurave të familjes.

Eshtë e mundëshme që të kërkohet një djetë e caktuar për arsye shëndeti ose për arsye feje.

Për tu rregjistruar në shërbimin e mencës shkollore duhet të plotësohet një formular i gatshëm, i cili i dorëzohet Sekretarisë Komunale.

Në rast se prindi kërkon reduktimin e kuotës për mencën e shkollës, duhet të plotësojë një formular në formë auto-çertifikate ku deklaron të ardhurat e të gjithë familjes.


Duhet paraqitur karta e identitetit e prindit (ose pashaporta).

Në sekretarinë e shkollës dorëzohen

- modeli 101 ose 740
- kërkesa për dietën e veçantë për arsye feje apo shëndeti.

Për pyetje të mundëshme apo për çfarëdolloj problemi tjetër, drejtohuni tek sekretarija e shkollës.

Adresa Via Perego NR. Tel. 0342/526262



5

NE RAST SE PRINDERIT E FILLOJNE PUNEN SHPEJT DHE E MBAROJNE VONE?

Për të zgjidhur këto probleme, në disa shkolla organizohën edhe Aktivitete para-shkollës

Kërkoni informacione në sekretarinë e shkollës në lidhje me kërkesën që duhet paraqitur.

6

MESIMI I FESE KATOLIKE APO ZGJEDHJE ALTERNATIVE?

Për dy ore ne jave parashikohet mesimi i fese katolike
Në momentin e rregjistrimit prindërit duhet të deklarojnë nëse:
këtë lloj mësimi. Në rast se prindërit vendosin të mos u mësojnë
fenë katolike fëmijëve të tyre, duhet të zgjedhin midis dy
mundësive alternative:

- aktivitete mësimi dhe formuese
- dalja nga shkolla

pranoj

nuk pranoj



CILI ESHTË KALENDARI SHKOLLOR?

Shkolla zgjat rreth 9 muaj.

Fillon nga mesi i shtatorit dhe përfundon në mes të qershorit.

Ka dy periudha pushimesh:

- dy javë për Krishtlindje (zakonisht nga data 23 dhjetor deri në datën 6 janar)
- rreth një javë për Pashkë (në muajin mars ose prill)


Ditët e tjera të pushimeve janë të shpërndara gjatë vitit dhe varen nga vendimet e shkollave të veçanta.

Shkolla do t'ju japi fëmijëvekalendarin vjetor te leksioneve.



Mungesat

Çdo mungesë duhet të justifikohet gjithmonë nga prindërit. Edhe në rastet kur fëmija vjen në shkollë me vonesë, ose kur duhet të dalë nga shkolla përpara orarit të caktuar, duhet të paraqesë një justifikim me firmë nga prindërit.



8

ÇFARE MESOJNE FEMIJET NE SHKOLLE?

Në shkollën fillore fëmijët studiojnë:

- gjuhë italiane
- matematikë
- shkenca
- histori
- gjeografi
- teknologji dhe informatik
- anglisht
- vizatim (arte dhe pamje)
- gjimnastikë (shkencat e lëvizjes)
- edukim muzikal (këngë dhe muzikë)

9

SI VLERESOHEN RREZULTATET SHKOLLORE?

Çdo vit shkollor ndahet në dy pjesë (2 semestra): nga shtatori në janar dhe nga shkurti në qershor.

Në janar dhe në qershor mësuesit bëjnë vlerësimin e rezultateve shkollore të nxënësve dhe përgatisin dokumentin e vlerësimit “dëftesën” e cili i jepet familjes.



10

PER ÇFARE SHERBEJNE TAKIMET MIDIS PRINDERVE DHE MESUESVE?

Mësuesit, në mënyrë periodike takohen me prindërit për të folur me ta në lidhje me programin e klasës, në lidhje me fëmijët, për vështirësitë dhe ecurinë e tyre.

Këto momente takimi janë shumë të rëndësishme sepse në këtë mënyrë shkolla dhe familja mund të bashkëpunojnë për edukimin e nxënësve dhe për integrimin e tyre të mirë.

Takimet

Çdo mësues njofton prindërit në lidhje me ditën në të cilën ai mund të takohet me ta për të folur për fëmijën e tyre ndërmjet mediatoreve të gjuhës shqipe.

Edhe prindërit mund të kërkojnë një takim me mësuesit.

Në rast se dëshironi të flisni për fëmijën tuaj, kërkonit menjëherë një takim me mësuesit.





NE RAST SE FEMIJA NUK E NJEH ITALISHTEN?

Për ta ndihmuar fëmijën tuaj për tu integruar me klasën dhe për të
mësuar gjuhën e re, mësuesit organizojnë disa aktivitete individuale
dhe aktivitete për mësimin e gjuhës italiane të shkruar dhe të folur.
*Në disa shkolla ka mësues të specializuar të cilët kanë për detyrë të
mësojnë italishten nxënësve të huaj, duke i mbledhur në grupe të
vogla.*

PRINDERVE TE HUAJ

Si funksionon shkolla dytësore e shkallës së parë në Itali



10 informacionet e para për mirëpritjen e fëmijëve tuaj

MIRESEVINI


në vëndin tonë dhe në shkollat tona

Para së gjithash, u themi juve dhe fëmijëve tuaj



“Mirësevini” në Itali dhe në shkollën italiane.


Më poshtë ju japim disa informacione mbi shkollën dytësore të shkallës së parë, e cila shpesh quhet shkolla e tetëvjecare

Rregjistroni menjëherë fëmijët tuaj edhe nëqoftëse viti shkollor ka filluar dhe mos harroni që të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë edhe nqs nuk janë në rregull me dokumentacionin e nevojshëm për qëndrim (OKB, Konventa Internacionale mbi të Drejtat e Fëmijës, Neni 28 e DPR 394/99).



BUON GIORNO!





SA VJET ZGJAT SHKOLLA NE ITALI?

Çerdhja deri në 3 vjeç

Shkolla e fëmijërisë nga 3 deri në 6 vjeç

Shkolla fillore nga 6 deri në 11 vjeç

Shkolla tetëvjeçare nga 11 deri në 14 vjeç

Shkolla e mesme mbi 14 vjeç

Cikli i parë i shkollimit zgjat 8 vjet:


- 5 vjet të shkollës fillore
- 3 vjet të shkollës tetëvjeçare

Konkludohet me një provim përfundimtar.

Rregjistrimi në shkollë është falas. Librat shkollorë nuk janë falas dhe duhet të blihen nga familja. Edhe pajisjet shkollore (fletore, stilolapsa, lapsa me ngjyra, etj.) duhet të blihen nga nxënësi.

Nxënësit me vështirësi ekonomike kanë mundësi të marrin librat borxh për vitin shkollor.

Kërkoni informacion pranë sekretarisë së shkollës.





ÇFARE DOKUMENTASH NEVOJITEN PER TE RREGJISTRUAR FEMIJET NE SHKOLLEN E MESME DYTESORE TE SHKALLES SE PARE?

Për të rregjistruar fëmijën në shkollë, prindi duhet të plotësojë një formular i cili i jepet në Sekretari.

Në të bëhet një autodeklaratë në lidhje me datën e lindjes së nxënësit dhe jepen edhe të gjitha informacionet e kërkuara.

Nëqoftëse ka këto dokumenta:

- certifikatën e lindjes
- certifikatën e vaksinimit
- deklaratën e shkollës që ka frekuentuar në vëndin prej nga vjen

mund ti dorëzojë në Sekretari.

Në momentin e rregjistrimit plotësohen formularët për:

- zgjedhjen e llojit të shkollës (shih numrin 3)
- mësimin e fesë katolike (shih numrin 6)
- rregjistrimin në mensën e shkollës (shih numrin 4)

Në rast se nuk keni certifikatën e vaksinimit, drejtojuni asistentit shëndetësor të shkollës, i cili do t'ju thotë ç'farë të bëni.





ÇFARE TIPI TE SHKOLLES DYTESORE TE SHKALLES SE PARE ?

Në shumë shkolla, prindërit mund të zgjedhin midis dy varianteve të orareve dhe të organizimit shkollor:

- **shkolla me “kohë normale”:**

bëhen 30 orë në javë të detyrueshme, në mëngjesë, nga e hëna deri të shtunën nga ora _____ deri në orën _____.

- **shkolla me “kohë të zgjatur”:**

parashikon kohën normale, plus një mbasdite prej 3 orësh nga ora _____ deri në orën _____

Kërkoni menjëherë orarin e klasës së fëmijës tuaj.



4

MESIMI I FESE KATOLIKE APO ZGJEDHJE ALTERNATIVE?

Për një orë në javë parashikohet mësimi i fesë katolike.

Në momentin e regjistrimit prindërit duhet të deklarojnë nëse fëmijët do të bëjnë këtë lloj mësimi apo jo.

pranoj

nuk pranoj

CALENDARIO SCUOLA

Sett	Ott	Nov	Dic	Gen	Feb	Mar	Apr	Mag	Giun
Red	Yellow	Yellow	Red	Yellow	Yellow	Yellow	Red	Yellow	Red





CILI ESHTË KALENDARI SHKOLLOR?

Shkolla zgjat rreth 9 muaj.

Fillon nga mesi i shtatorit dhe përfundon në mes të qershorit.

Ka dy periudha pushimesh:

- dy javë për Krishtlindje (zakonisht nga data 23 dhjetor deri në datën 6 janar)
- rreth një javë për Pashkë (në muajin mars ose prill)

Ditët e tjera të pushimeve janë të shpërndara gjatë vitit dhe varen nga vendimet e shkollave të veçanta.

Shkolla do t'ju njoftojë çdo herë për ditët e mundëshme të pushimeve, nëpërmjet një lajmërimi në ditarin e fëmijës tuaj.

Kontrolloni gjithmonë ditarin!

Mungesat

Çdo mungesë duhet të justifikohet gjithmonë nga prindërit.

Edhe në rastet kur fëmija vjen në shkollë me vonesë, ose kur duhet të dalë nga shkolla përpara orarit të caktuar, duhet të paraqesë një justifikim me firmë nga prindërit.

6

ÇFARE MESOJNE FEMIJET NE SHKOLLE?

Shkolla tetëvjecare shoqëron nxënësit për tre vjet për të arritur objektivet e mëposhtëme

- Hapjen e njohurive neper mjet lendeve base
- Te jene te pavarur dhe te pergjegjshem
- Te jene ne gjendje te zgjedhin shkollen e mesme me te pershtatshme
- Te jene te edukuar per paqen dhe solidaritetin
- Te kujdesen per shendetin dhe per ambjentin

Në shkollën dytësore të shkallës së parë fëmijët studiojnë:

- italisht
- anglisht
- gjuhë tjetër të komunitetit europian
- histori
- gjeografi
- matematikë
- shkenca
- teknologji
- informatik
- muzik
- arte dhe pamje
- shkenca të gjimnastikës dhe sporteve





SI VLERESOHEN RREZULTATET SHKOLLORE?

Çdo vit shkollor ndahet në dy pjesë (2 semestra): nga shtatori në janar dhe nga shkurti në qershor.

Në janar dhe në qershor mësuesit bëjnë vlerësimin e rrezultateve shkollore të nxënësve dhe përgatisin “dokumentin e vlerësimit” i cili i jepet familjes.

Gjatë semestrit jepen detyra në klasë të cilat shërbejnë për të bërë një vlerësim të semestrit të parë dhe atij të dytë.



8

PER ÇFARE SHERBEJNE TAKIMET MIDIS PRINDERVE DHE MESUESVE?

Mësuesit, në mënyrë periodike takohen me prindërit për të folur me ta në lidhje me programin e klasës, në lidhje me ecurinë dhe vështirësitë e nxënësve.



Këto momente takimi janë shumë të rëndësishme sepse në këtë mënyrë shkolla dhe familja mund të bashkëpunojnë për edukimin e nxënësve dhe për integrimin e tyre të mirë.

Takimet

Çdo mësues njofton prindërit në lidhje me ditën në të cilën ai mund të takohet me ta për të folur për fëmijën e tyre.

Edhe prindërit mund të kërkojnë një takim me mësuesit.

Në disa raste është e parashikuar edhe prezenca e mediatrorëve.



fx

9

NE RAST SE FEMIJA NUK E NJEH ITALISHTEN?

Për ta ndihmuar fëmijën tuaj për tu integruar me klasën dhe për ti mësuar gjuhën e re, mësuesit organizojnë disa aktivitete individuale dhe aktivitete për mësimin e gjuhës italiane të shkruar dhe të folur. *Në disa shkolla ka mësues të specializuar të cilët kanë për detyrë tu mësojnë italishten nxënësve të huaj, duke i mbledhur në grupe të vogla.*

10

CILAT JANE TE DREJTAT DHE DETYRAT E NXENESEVE?

Nxënësit janë të detyruar të prezantohen në shkollë me të gjithë materialin e duhur, me justifikim në rast mungesash; duhet të kujdesen për higjenën e trupit dhe të veshjes, të respektojnë shokët dhe shoqet e klasës, mësuesit dhe ambjentin shkollor. Meshkujt dhe femrat i kanë të drejtat njësoj; të gjithë kanë të dejtë të mirëpreiten dhe të ndihmohen në ecurit shkollore

DHE NEQOFTESE DESHIRONI TE DINI ME TEPER?

Mos u shqetesoni!

Ekzistojne qendra qe mund tu japin informacione concrete.

1. CMAI
Qendra e pritjes së emigrantëve
Via Lavizzari 4 SONDRIO
Tel. 0342 211554
2. CTP
Qendra Territoriale e Përherëshme
Via Diego Gianoli 15- SONDRIO
Tel. 0342510868
3. Zyra e Arsimit te Rrethit
Via Nazario Sauro 64 – SONDRIO
Tel. 0342541111

PER JU PRINDER

Per ju prinder jepet mundesia per te mesuar gjuhen italiane, mund te regjistrohemi prane CTP qendra e territorit permanent pe instruktimin dhe formin ne moshe te madhe qe ju ndihmon te integrohemi ne nje vend ne transformim.

Te interesuarit duhen te plotesojne nje kerkese qe ju jepet ne sekretari e cila gjendet ne shkollen e mesme F.Sassi dhe L.Torrelli ne rrrugen Diego Gianoti, 16 ne Sondrio. Tel.(0342/51 0868)

